

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 03/08/2023, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSE: Z. Renis TËRSHANA, lindur më 23.09.1971, në Tiranë, shtetas Shqiptar, me adresë Rr. Elbasanit, Pallati Tërshana 2, 01101, Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Personal H10923040R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e Shitësit),

DHE

BLERËSI: Z. Florian NEPRAVISHTA, lindur më 12.08.1962, në Tiranë, shtetas Shqiptar, me adresë R. Kont Urani, nr. 4, Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. Personal G20812044O, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e Blerësit).

OBJEKTI: Shitja e 129,275 (njëqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) aksioneve të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksioneri **Z. Renis TËRSHANA** dhe blerja e tyre nga **Z. Florian NEPRAVISHTA**.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal NR. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakord që 129,275 (njëqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) aksione të shiten me një çmim 1.7018 euro/aksion, me çmimin total prej 220,000.20 (dyqind e njëzetë mijë pikë njëzetë) Euro.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.



MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë Blerësit 129,275 (njëqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) aksione të shoqërisë "BANKA CREDINS" sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 220,000.20 (dyqind e njëzetë mijë pikë njëzetë) Euro nga ana e Blerësit **Florian NEPRAVISHTA**, në llogarinë e Shitësit **Renis TËRSHANA**.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM

Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.


TË TJERA

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.


SHITËSI

BLERËSI

Renis TËRSHANA



Florian NEPRAVISHTA



00 TIRANE, 04/08/2023-14:51

Veprimi kaloi sipas urdherit tuaj

I NDERUAR Z.
NEPRAVISHTA FLORIAN
FASLLI
RRUGA KONT URANI NR 4 TIRANE
TIRANE TR

REF: 23001153729/CF1572TR 000223663503

VV 040823 14:52

Llogaria e urdhëruesit D01 00001761289 EUR	220.000,00
Llogaria e përfituesit C01 00000012928 EUR	220.000,00
Përfituesi: TERSHANA RENIS	

Vlera e veprimit	EUR	220.000,00
Përshkrimi:		
SA BLERE AKSIONE NGA RENIS TERSHANA SIPAS KONTRATES SE BLERJES SE AKSIONEVE DT 3.8.2023 GJITHSEJ 129275 AKSIONE		



Veprimi kaloi sipas urdhërit tuaj

00 TIRANE, 22/08/2023-11:54

I NDERUAR Z.
NEPRAVISHTA FLORIAN
FASLLI
RRUGA KONT URANI NR 4 TIRANE
TIRANE TR

REF: 23001238804/CF1684TR 000225014254

AY 220823 11:54

Llogaria e urdhëruesit D01 00001761289 EUR	0,20
Llogaria e përfituesit C01 00000012928 EUR	0,20
Përfituesi: TERSHANA RENIS	

Vlera e veprimit	EUR	0,20
Përshkrimi:		
DIFFERENCE E PAGESES PER BLERJE AKSIONE NGA TERSHANA RENIS		

